

ME KUJDES, PLOT SHPRESË!

Një projekt i Agjencisë Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

Zbatuar nga:



Save the Children

Në bashkëpunim me:



REPUBLIKË E SHQIPËRI
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE



REPUBLIKË E SHQIPËRI
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINËS

Hej, unë jam Leo.



Hej, unë jam Nina.



Ne kemi një mision shumë të rëndësishëm:

TË MPOSHTIM KORONAVIRUSIN, ARMIKUN TONË TË PËRBASHKËT.

Po ju tregojmë kush është Koronavirusi dhe çfarë rreziku përbën ai për ne.

Koronavirusi është një mikrob dhe që të jetojë dhe shumohet i duhet të përhapet në sa më shumë njerëz.



Nëse ai arrin të futet brenda trupit tonë, ne rrezikojmë ta përhapim atë tek njerëzit tanë të dashur duke u qëndruar pranë.



Disa ditë pasi koronavirusi është futur brenda trupit tonë, ne fillojmë të ndihemi të sëmurë.

Mund të kemi temperaturë, kollë, dhimbje fyti dhe të ndihemi të pafuqishëm. Fatmirësisht, trupi ynë ka organizma mbrojtëse që e luftojnë atë.



Por, thonë që njerëzit më të moshuar, e kanë të vështirë për ta luftuar, prandaj ne duhet të përpiqemi shumë ta luftojmë koronavirusin për prindërit dhe gjyshërit tanë.

Koronavirusi është një armik shumë i rrezikshëm, pasi ne nuk mund ta shikojmë.

Por mos u trembni shokët e mi, pasi ne do ju tregojmë se si ta mposhtim atë të gjithë bashkë.



Çdo rregull që zbatojmë është një etapë më vete.

Është njësoj si të luash një videolojë.



**Po ju tregojmë etapat që duhet të ndiqni,
derisa të gjithë bashkë ta mundim virusin:**



Etapë 1.

Vendosni gjithmonë maskë
kur dilni nga shtëpia!

Etapë 2.

Lani duart me sapun dhe ujë të
rrjedhshëm për rreth 20 sekonda
dhe thajini me peshqir të pastër!



Etapë 3.

Në rast se ndiheni
të sëmurë, mos shkoni në
shkollë, por qëndroni në shtëpi!



Etapë 4.

Flini gjumë mjaftueshëm dhe ushqehuni mirë!

Etapë 5.

Shmangni prekjen e syve, hundës dhe gojës!



Etapë 6.


Mbulojeni gojën me bërryl kur teshtini ose kolliteni!

Ju sigurojmë që nëse të gjithë ndjekim etapat
e lojës, brenda një kohe të shkurtër, të gjithë
bashkë do të fitojmë.

Maska, higjena dhe pastëria janë arma jonë.
Me pak kujdes, të gjithë së bashku do i japim
botës shpresë!

**Dhe mos harroni, të gjithë mbajnë maska!
Me kujdes, plot shpresë!**





ME KUJDES, PLOT SHPRESË!

Një projekt i Agjencisë Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

Zbatuar nga:



Save the Children

Në bashkëpunim me:



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBRROTJES SOCIALE



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINIE